



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-018
Prishtinë, më 23 maj 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 23 MAJ 2011

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ibrahim Makolli, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Sasha Rashiq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozim të kryesuesit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 maj 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 maj 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 maj 2011.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjet plenare që do të mbahet më 27 maj 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 27 maj 2011, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmë juridike falas,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për efikasitetin e energjisë,
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010,
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2010,
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010.

3. Shqyrtimi i Rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Rekomandimi i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për iniciimin e procedurës për emërimin e një anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga grupet parlamentare që, në bazë të nenit 4 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin, deri më 30 maj 2011, ta propozojnë nga një kandidat për anëtar në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media, sipas rregullave procedurale të miratuara nga Kuvendi, në korrik të viti 2006.

Pika shtesë :

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar të Komisionit për Integritet Evropianë në Kroaci

Kryesia, pasi diskutoi lidhur për këtë çështje, nxori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Komisionit për Integritet Evropiane, në Kroaci, prej 29 maj deri më 1 qershor 2011, në këtë përbërje: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Blerim Shala, Blerta Deliu Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Suzana Novoberdali dhe Albert Kinolli, anëtarë të Komisionit, si dhe Ahtere Loxha, staf mbështetës i Komisionit.

2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet përballohen nga buxheti i Kuvendit.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën **11:25** minuta.

Nënkryetari i Kuvendit,

Sabri HAMITI

Procesverbalin hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.